



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Datë: 24.01.2014
Nr. 0204-118

PËR: Agim Bahtiri, Kryetar i Komunës së Mitrovicës
Bislim Imeri, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Mitrovicës

LËNDA: KONFIRMIM I LIGJSHMËRISË SË VENDIMIT TË KUVENDIT TË KOMUNËS SË MITROVICËS Nr. 02/06-208/6 ,të pranuar me datën 23.01.2014

Të nderuar,

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, në përputhje me mandatin e saj të përcaktuar me Ligjin Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, Ligjin Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, shtojcën XII të Rregullores Qeveritare, Nr. 02/2011 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, pas shqyrtimit të vendimit Nr. 02/06-208/6, të miratuar me datë 16.01.2014 nga Kuvendi i Komunës së Mitrovicës **KONFIRMON** ligjshmërinë e aktit dhe vlerëson se i njëjti është në harmoni me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale.

Akti juridik i cili prodhon efekt të plotë juridik.

- Vendim Nr. 02/06-208/6 për formimin e komisionit për draftimin e Statutit të Komunës.

Me respekt,

Slobodan Petrović,
Zëvendës Kryeministër & Ministër i MAPL,

Kopje: Besnik Osmani, Sekretari i Përgjithshëm në MAPL-së
Udhëheqësve të Departamenteve të MAPL-së
Arkivit të MAPL-së



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Dana: 27.01.2014
Br. 0204-118

Za : Agim Bahtiri, Gradonačelnik Opštine Mitrovica
Bislim Imeri, Predsedavajući Skupštine Opštine Mitrovica

PREDMET: POTVRDA ZAKONITOSTI ODLUKE SKUPŠTINE OPŠTINE
MITROVICA, Br. 02/06/208/6, primljena dana 23.01.2014

Poštovani,

Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave, u skladu sa svojim mandatom određenim po Zakonu br. 03/L-040 za Lokalnu samoupravu, dodatku XII Uredbe Vlade, Br. 02/2011 o poljima Administrativne odgovornosti kabineta Premijera i Ministarstva, posle razmatranja Odluke Br. 02/06/208/6 usvojene dana 16.01.2014 od Skupštine Opštine Mitrovica, **POTVRDJUJE zakonitost** akta i ceni da je isti u skladu sa Zakonom za lokalnu samoupravu.

Pravni Akti koji proizvodi puni pravni efekat.

- Odluka br.02/06/208/6, o formiranju komisije za draftovanje Statuta Opštine.

S poštovanjem,


Slobodan Petrović,
Zamenik Premijera & Ministar MALS-a

Kopija: Besnik Osmani, Generalni Sekretar MALS-a
Rukovodiocima Uprava MALS-a
Arhivu MALS-a



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Mitrovicës
Opština Mitrovica - Municipality of Mitrovica



KUVENDI I KOMUNËS
Nr. 02/06-208/6 dt. 16.01.2014
Mitrovicë

Në bazë të nenit 12, paragrafi 2, alineja a, nenit 40, paragrafi 2, alineja a, dhe nenit 58 alineja h, të Ligjit Nr. 03/L-040 Për vetëqeverisje lokale (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2009), Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më dt. 16.01.2014 pasi shqyrtoi Propozim-vendimin për formimin e Komisionit për draftimin e Statutit të Komunës; sjellë këtë:

VENDIM

Për formimin e Komisionit për draftimin e Statutit të Komunës

1. Me këtë Vendim formohet Komisioni për draftimin e Statutit të Komunës në këtë përbërje:

- 4 anëtarë të Kuvendit të Komunës;
- 2 anëtarë të Ekzekutivit të Komunës;
- 2 zyrtarë të administratës së Komunës; dhe
- 1 anëtar i shoqërisë civile.

Obligohen grupet e anëtarëve të Kuvendit, që në mbledhjen e radhës së Kuvendit të Komunës të japin emrat e anëtarëve të Komisionit për draftimin e Statutit të Komunës.

2. Komisioni është përgjegjës për zhvillimin dhe mbikëqyrjen e procedurave të hartimit të Statutit të Komunës, sipas Ligjit Nr. 03/L-040 Për vetëqeverisjen lokale dhe Rregullores Nr. 01/2013 Për procedurën e hartimit dhe publikimit të akteve të Komunave.

3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në ueb faqen e Komunës.

Mitrovicë

Kryesuesi i Kuvendit


Bislim IMERI

Dorëzohet:

- 1 x 1 Kryesuesit të Kuvendit
- 1 x 1 MAPL
- 1 x 1 Arkivit
- Kopje: Kryetarit të Komunës